

BULETIN INFORMATIV



Zhvillimet në fushën e politikave dhe legjislacionit që garantojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara • Janar 2020 - Mars 2020



Përmbajtja

- 1** Vendim nr. 874, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal”.
- 2** Vendim nr. 866, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”.
- 3** Vendim nr. 182, datë 26.2.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal”.
- 4** Vendim nr. 176, datë 26.2.2020 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 659, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për punësim dhe aftësi 2019–2022 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
- 5** Vendim nr. 17, datë 15.1.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”.
- 6** Vendim nr. 177, datë 26.2.2020 “Për përbërjen, kriteret dhe detyrat e bordit të administrimit të fondit social të punësimit dhe mënyrat e përdorimit të tij”.
- 7** Urdhër nr. 102, datë 21.2.2020 “Për procedurat standarde të veprimit (psv) për punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, për zvogëlimin e rrezikut të përjetimit të dhunës në familje e të dhunës me bazë gjinore, në situata të emergjencave civile.”
- 8** Vendim nr.236, datë 19.3.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”

VENDIM Nr. 874, datë 24.12.2019 “PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË NDIHMESËS PERSONALE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NDIHMËSIT PERSONAL”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” është aprovuar ky vendim i cili përcakton mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale; ii. dokumentacionin dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal; iii. monitorimin e ndihmesës/asistencës personale dhe mbështetja për një shërbim cilësor. Sipas këtij vendimi, ndihmësi personal është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara, për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme. Ndhmësi personal ofron ndihmesën/asistencën personale në cilësinë e ndihmësit, për: a) kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara; b) shoqërues për personat e verbër; c) interpretues i gjuhës së shenjave; dhe ç) lehtësues në komunikim për personat me aftësi të kufizuara, në të folur dhe në të dëgjuar, dhe synon t'i vij në ndihmë personit me aftësi të kufizuara, për: a) realizimin e veprimtarive për përmbushjen e nevojave themelore për të mundësuar të jetojë me dinjitet; b) shoqërimin jashtë shtëpisë për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fetare; c) shoqërimin për marrjen e shërbimeve sociale, shëndetësore, rehabilituese e integruese dhe shoqërimin për në shkollë për fëmijët e moshës shkollore; ç) marrjen në kohë të mjekimeve, sipas rekomandimit të mjekut; dhe d) mbajtjen e higjienës personale. Mbështetja në komunikim përfshin, por nuk

kufizohet te: a) shërbimet e përkthyesit të gjuhës së shenjave; b) ndihma për të komunikuar nëpërmjet ligjëritimit dhe/apo shenjave të veçanta; c) ndihma në përdorimin e programeve që ndihmojnë komunikimin përmes figurave; ç) përshtatja e informacionit të shkruar, sipas nevojave.

Ndhmësit personalë ofrojnë ndihmesën/asistencën personale nën drejtimin dhe udhëzimet e vetë personave me aftësi të kufizuara, edhe në rastet kur personi me aftësi të kufizuara është asistuar nëpërmjet mbështetjes me ndihmë në vendimmarrje, ose nën drejtimin dhe udhëzimet e përfaqësuesve ligjorë të personave me aftësi të kufizuara. Ndhmësi personal zgjidhet nga vetë përfituesi dhe/ose nëpërmjet mbështetjes me ndihmë në vendimmarrje, ose nga kujdestari ligjor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Shërbimet e ndihmësit personal mund të ofrohen nga: a) anëtarë të familjes; b) kujdestarë ligjorë; c) të afërm ose miq; ç) punonjës të fushës sociale apo çdo person tjetër që ka marrë kualifikimet e kërkuara për ofrimin e këtij shërbimi; d) subjektet publike/jopublike që ofrojnë shërbime të ndihmësit personal, për ofrimin e këtij shërbimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dh) organizata shërbimesh, të ngritura nga persona me aftësi të kufizuara.

Për më tepër, shikoni dokumentin e plotë në linkun:
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/874/020e6570-846d-4bbd-b2de-9e74b76c3a84>

VENDIM Nr. 866, datë 24.12.2019 “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË MBROJTJES SOCIALE, 2020–2023, DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË SAJ”

Strategjia gërsheton politika dhe programe specifike për të reduktuar varfërinë, duke zvogëluar ekspozimin e familjeve dhe popullatës/njerëzve ndaj rreziqeve dhe duke rritur kapacitetin e tyre për të mbrojtur veten nga rreziqet dhe mungesa e të ardhurave. Propozon ndërhyrje prioritare nëpërmjet zbatimit të programeve të ndihmës ekonomike, sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore e shëndetësore, duke përfshirë mbrojtjen e familjeve, fëmijëve dhe popullatës bazuar në skema makro (në nivel kombëtar) dhe në nivel mikro (në nivel bashkie, qyteti, fshati, komuniteti, familje), si dhe procesin e rikthimit drejt tregut të punës me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për çdo individ dhe familje. Strategjia synon të përmirësojë mirëqenien fizike, shoqërore dhe

ekonomike të individëve, fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomikisht të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale. Strategjia synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe fëmijët. Varfëria do të ulet, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritimit në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore. Familja ka një aspekt mbështetës prioritar në këtë strategji në drejtim të konsolidimit të skemës së re të NE-së, duke prioritetuar shënjestrimin më të mirë të familjeve të prekura nga varfëria dhe duke i mbështetur ato nëpërmjet sigurimit të asistencës afat-shkurtër për familjet/personat në nevojë dhe inkurajimin e mbështetjen e ▶▶

tyre për daljen nga skema duke hartuar dhe zbatuar një program të veçantë “daljeje”, i cili siguron mekanizmat e punësimit të anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese të skemës së NE-së, të cilët kanë periudhë të kufizuar qëndrimi në skemë

Risi e kësaj strategjie është reformimi i parimeve dhe sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke propozuar një model të ri multidisiplinor biopsikosocial i bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për vlerësimin në tërësi të nevojave të individit, i rritur apo fëmijë, me aftësi të kufizuara dhe jo duke u fokusuar vetëm në diagnostikimin e tyre. Qasja e re përfshin një paketë të plotë të integruar për PAK-në që nga identifikimi i hershëm, diagnostikimi, vlerësimi i nevojave, menaxhimin e rastit të plotë që nga këshillimi, rehabilitimi nëpërmjet shërbimeve të specializuara sociale dhe shëndetësore, dhe sipas rastit edhe integrimi për punësim dhe arsimim apo kualifikime profesionale. Një objektiv specifik është edhe krijimi i sistemit të integruar të shërbimeve shoqërore dhe shëndetësore në nivel vendor për familjen, fëmijët dhe individët në nevojë. Lidhja midis “shërbimeve shëndetësore” dhe “shërbimeve sociale” lejon trajtimin multidisiplinor për individin dhe familjen e tij/saj. Zhvillimi i shërbimeve të përkujdesjes alternative, është një përgjigje ndaj institucionalizimit të grupeve në nevojë, sidomos fëmijëve. Shërbimet e asistencës shtëpiake për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuar, shërbimet për familjen dhe prindërimin, transformimi i institucioneve të përkujdesjes sociale, janë prioritetet thelbësore të strategjisë.

Për herë të parë nëpërmjet krijimit të një linje buxhetore të veçantë, Fondit Social, dhe alokimit të buxhetit qendror, mundësohet që çdo bashki të ngrejë shërbime shoqërore në territor për grupet në nevojë duke garantuar shërbimet shoqërore minimale (apo shportën e shërbimeve), si dhe qëndrueshmëri të shërbimeve aktuale sipas

nevojave të specifikuar në Planin Social të çdo bashkie.

Bashkëpunimi i mirë midis një qeverie me mendësi të orientuar drejt shërbimit dhe një shoqërie civile aktive, kritike dhe konstruktive përbën një element të domosdoshëm për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe për garantimin e mbrojtjes sociale për të gjitha grupet.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020–2023 identifikon qëllimet dhe objektivat e mëposhtëm për realizimin e politikave: A. Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve, fëmijëve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, duke përmirësuar shënjestrimin e tyre, rritjen e transparencës dhe shmagjen e abuzivitetit në skemën e Ndhmës Ekonomike, si dhe lidhjen me skemat e punësimit, me shërbime të integruara me qëllim riintegrimin social të tyre në jetën shoqërore; B. Zhvillimin e Aftësisë së Kufizuar nëpërmjet vlerësimit biopsikosocial bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në para me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike; C. Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale me synim që deri në vitin 2023, çdo burrë, grua, djalë dhe vajzë do të ketë mundësi të barabartë të përfitojë nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Për më tepër mbi ndërhyrjet, masat specifike, afatet dhe buxhetet për realizimin e tyre shikoni dokumentin e plote në <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/866/878fbd77-15bf-4fa7-9666-dec4070ec5e0>

VENDIM Nr. 182, datë 26.2.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE E DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, SI DHE TË NDIHMËSIT PERSONAL”

Ky vendim ka dalë në mbështetje të neneve 13 e 17, pika 1, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” dhe përcakton: i. kriteret e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar; ii. vlerësimin e aftësisë së kufizuar; iii. masën e përfitimit të aftësisë së kufizuar; iv. procedurat dhe dokumentacionin për vlerësim dhe përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe v. procedurat e ankimit në komisionin epror.

Sipas pikës 1, Kreu I, të këtij vendimi, përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar personat e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të nenit

8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshja; b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Përsa i përket masës së përfitimit VKM përcakton se masa e ▶▶

përfitim të aftësisë së kufizuar, për personat me aftësi të kufizuar, e përcaktuar sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, është 10 653 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj. Të njëjtën masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuar, i përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Ndërsa pagesa e ndihmësit personal të personit me aftësi të kufizuar, sipas shkronjës “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, është në masën 11 190 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj. Kjo pagesë indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit. Periudha e shërbimit si ndihmës personal për personat e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrëlindeje, aksidenti në punë, sëmundjeje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Kontributet paguhen në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohen nga buxheti i shtetit. Ndihmësit personalë, që ofrojnë shërbim për më shumë se një përfitues, marrin një shtesë prej 50% të shumave përkatëse për çdo përfitues të shtuar. Përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar nuk llogaritet në të ardhurat e familjes, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar dhe pagesa e ndihmësit personal indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

Personat me aftësi të kufizuar, që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar ose të akredituar, dhe nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin kursin e kualifikimit/vitin shkollor vetëm për një dhe gjatë një kursi kualifikimi/viti shkollor, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e kursit të kualifikimit/vitit shkollor. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit. E njëjta masë pagese zbatohet për personat që ndjekin programin e studimit të ciklit të tretë. Për personat që ndjekin studimet e doktoratës dhe për personat që ndjekin procedurat për fitimin e një titulli akademik, kjo pagesë përfitohet në mënyrë të përhershme, mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente për fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

Përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Pagesa për personat që përfitojnë nga ky vendim dhe e ndihmësit personal bëhet një herë në muaj, nëpërmjet shërbimit bankar ose Postës Shqiptare, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.

Përsa i përket procedurës dhe dokumentacionit për vlerësim dhe përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, vendimi përcakton që personat, që vlerësohen me aftësi të kufizuar, pajisen nga institucioni i kujdesit shëndetësor, i specializuar me shtretër, me fletën e drejtimit për në KMCAP. Personat, që rivlerësohen për aftësinë e kufizuar, pajisen nga mjeku specialist me epikrizë, në bazë të rekomandimit të mjekut të familjes. Dokumentacioni për vlerësimin/rivlerësimin e aftësisë së kufizuar, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve nga institucioni shëndetësor pranë njësive administrative ku individi ka vendbanimin. Për personat me aftësi të kufizuar, për të cilët me vendim të komisionit mjekësor është përcaktuar se kanë nevojë për përkujdesje, plotësohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve dokumentacioni për ndihmësin personal, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor, e dërgon atë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, me procesverbal, pranë mjekut të drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror, dhe listën emërore të personave që do të vlerësohen apo do të rivlerësohen, pranë KMCAP-së. Mjeku verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMCAP. Mjeku mban regjistrin e personave me aftësi të kufizuar, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi. Në rastet e rivlerësimit, administratori shoqëror njofton personin 2 (dy) muaj para përfundimit të afatit të vlerësimit për pajisjen me epikrizën përcjellëse. Personat, të cilëve u ndryshon gjendja shëndetësore brenda afatit të përfitimit, i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit me fletëdrejtimit të re. Administratori shoqëror, në bazë të vendimeve të komisionit, përgatit listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar, të shoqëruar me masën e përfitimit për çdo përfitues, përfshirë edhe përfitimet shtesë, të bazuara në dokumentacionin përkatës, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo listë i dërgohet çdo muaj strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki për të kryer pagesat.

Sipas këtij vendimi nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit për përfitim si kategori e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me përcaktimet në këtë vendim, individët, të cilët janë kategori përfituese e pagesave të aftësisë së kufizuar sipas vlerësimit biopsikosocial, të përcaktuar në vendimin nr. 722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”.

Ky vendim, shfuqizon vendimin nr. 618, datë 7.9.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”. Për më tepër lexoni të plotë vendimin në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/02/26/182/057e722a-8468-4ca3-9e95-dc1c758935b1>

VENDIM Nr. 176, datë 26.2.2020 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 659, datë 10.10.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PUNËSIM DHE AFTËSI 2019–2022 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ”

Ky vendim parashikon miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në planin e veprimit dhe pasaportën e indikatorëve të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022. Në planin e veprimit të paraqitur në tabelën bashkëlidhur strategjisë, janë të shprehura objektiva dhe masa konkrete përgjatë gjithë dokumentit, të cilat synojnë aftësimin profesional e punësimin e personave me aftësi të kufizuara, si pjesë e grupeve të vecanta, përmes shërbimeve të arsimit e formimit profesional të ofruara nga subjekte publike dhe private, por në mënyrë më specifike këto masa pasqyrohen në kapitullin (C)

i cili fokusohet tek promovimi i përfshirjes sociale dhe i kohezionit territorial, me objektiv specifik zgjerimin e mbulimit, përfshirjes dhe efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë dhe të rriturit, përfshirë dhe popullsinë e rrezikuar për përjashtim e më specifikisht, ndërhyrja C1 që synon rritjen e aksesit për shërbime të punësimit dhe të AFP-së për grupet e veçanta.

Për më tepër lexoni të plotë VKM në:

<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/02/26/176/187322d4-9ab9-4948-90ec-261911b149d1>

VENDIM Nr. 17, datë 15.1.2020 “PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE”

Ky vendim ka dalë në mbështetje të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, dhe përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve aktive të nxitjes së punësimit: a) programet e punësimit; b) formimit nëpërmjet punës; c) praktikave profesionale. Punëkërkuessit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuessit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 3 (tre) muaj në zyrën e punës, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga specialisti përkatës i punësimit. Punëkërkuessit e papunë me të drejtë përfitimi nga programet e punësimit, u përkasin disa kategorive dhe pjesë e tyre janë edhe kategoria e personave me aftësi të kufizuara. Programi subvencionon këto kosto: i. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuar çdo muaj; ii. financimin e pagës në shumën 100 (njëqind) % të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për afate të caktuar mujore, për kategori të ndryshme, ndërkohë që për pjesëmarrësit, persona me aftësi të kufizuara financimi është

për një periudhë 12 mujore i kompensuar çdo muaj.

Programi i formimit nëpërmjet punës ka si qëllim trajnimin në punë të punëkërkuessve, sipas nevojave të profilit të punës të kërkuar nga punëkërkuessit dhe të përshtatur me nevojat e punëdhënësit; Kohëzgjatja e subvencionimit të ofruar nga ky program do të jetë për një periudhë katërmujore për të gjitha profesionet; programi subvencionon kostot e mëposhtme: i. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të kompensuar çdo muaj; ii. financimin e pagës në shumën 100 (njëqind) % të pagës minimale në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuar çdo muaj; iii. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit) për tetë muajt e ardhshëm, të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, në rastet, kur, pas përfundimit të formimit nëpërmjet punës, punëdhënësi lidh kontratë punësimi të paktën tetëmuajore me punëmarrësin pas përfundimit të programit; iv. pagesën për mentorin në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë për çdo përfitues, pjesëmarrës të angazhuar nga ky punëdhënësi.



Programi i praktikave profesionale ka si qëllim të garantojë tranzicion të shpejtë në tregun e punës, në të njëjtën fushë ose në një fushë të ngjashme me atë, në të cilën ka studiuar i diplomuari, për një kohëzgjatje 6-mujore. Përfitues të këtij programi janë të gjithë punëkërkuarit e papunë, të cilët janë të sapodiplomuar, deri në 24 (njëzet e katër) muajt e fundit pas diplomimit, të cilët janë regjistruar si punëkërkuar të papunë. Programi subvencionon i. kontributet për sigurimin nga aksidentet në punë; ii. financim të pagës në shumën 50 (pesëdhjetë) % të pagës minimale në shkallë

vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuara çdo muaj. Përveç subvencionimit të kostove të mbuluara nga këto 3 programe, sipas këtij vendimi jepen edhe subvencione të tjera, një prej të cilave është shuma 200 000 (dyqind mijë) lekë për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara për punëdhënësit.

Për më tepër shiko tekstin e plotë të vendimit <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/01/15/17/afd1a173-daa4-443c-b580-2eb5e9e09fb2>

VENDIM Nr. 177, datë 26.2.2020 “PËR PËRBËRJEN, KRITERET DHE DETYRAT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË FONDIT SOCIAL TË PUNËSIMIT DHE MËNYRAT E PËRDORIMIT TË TIJ”

Ky vendim ka dalë në mbështetje të të pikës 6, të nenit 21, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”. Sipas këtij vendimi krijohet Fondi Social i Punësimit për të siguruar nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës, të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse, dhe administrohet nga Bordi i Administrimit të Fondit. Bordi i administrimit të fondit përbëhet nga nëntë anëtarë prej të cilëve dy përfaqësues të punëdhënësve, të përzgjedhur nga organizatat dhe dhomat e përfaqësimit të punëdhënësve/organizatat më të përfaqësuarat të punëdhënësve. Kandidatët, që përfaqësojnë organizatat e punëdhënësve, duhet të jenë nga sektorët që kanë punësuar persona me aftësi të kufizuara; një përfaqësues i personave me aftësi të kufizuara, i përzgjedhur nga organizata të shoqërisë civile, me eksperiencë pune dhe fokus në ndihmesën e personave me aftësi të kufizuara; dy ekspertë të pavarur, të caktuar nga organizatat e shoqërisë civile, me eksperiencë pune dhe fokus në ndihmesën e personave me aftësi të kufizuara. Bordi i Administrimit të Fondit Social të Punësimit ushtron disa detyra të përcaktuara në këtë vendim: a) administron Fondin Social të Punësimit, në përputhje me ligjin nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, dhe rregulloren e funksionimit të bordit; b) miraton strategjitë dhe planin e veprimit vjetor për përdorimin e fondit, duke përcaktuar prioritetet e veprimit, raportet përkatëse të shpenzimeve vjetore për secilin prioritet dhe duke ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin dhe financimin e projekteve për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara; c) miraton programet që financohen nga Fondi Social i Punësimit, në përputhje me procedurat ligjore dhe me rregulloren e funksionimit, dhe miraton nivelet dhe vlerat e financimit për projektet e paraqitura; ç) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të bordit; d) miraton të hyrat dhe

shpenzimet vjetore, raportet e auditimit financiar dhe raportet periodike të veprimtarisë së fondit; dh) analizon dhe miraton raportet e monitorimit e të vlerësimit të impaktit të projekteve të financuara nga fondi ose të kontraktuara nga ekspertë ose organizata; e) merr vendime dhe miraton dokumentet që lidhen me veprimtarinë e fondit. Fondi Social i Punësimit përdoret vetëm për financimin e projekteve me programe që synojnë: a) punësimin; b) vetëpunësimin; c) rehabilitim për punë; ç) aftësimin dhe riaftësimin profesional; d) orientimin dhe këshillimin për punësim; dh) shërbime mbështetëse; e) përshtatjen e vendit të punës për personat e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 4, të nenit 3, të ligjit për nxitjen e punësimit; ë) programe riintegrimi social; f) mbështetjen për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara; g) përshtatjen e vendit të punës, duke përfshirë rikonstrukcionin, për çdo person të punësuar sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”. Aplikimi për programe të financuara nga fondi bëhet në bazë të njoftimit për “thirrje për propozime”, i cili shpallet në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe në faqen e internetit të institucionit përgjegjës për punësim e aftësi. Të drejtën për të aplikuar për programe të financuara nga fondi e kanë çdo entitet kombëtar dhe ndërkombëtar publik/privat jofitimprurës dhe punëdhënësit, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me fushën e punësimit, të aftësimin profesional dhe zhvillimit të programeve të parashikuara në pikën 2, të këtij kreu, dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Bordi, në varësi të llojit të programit që do të financohet nga fondi, përcakton dhe miraton kriteret e vlerësimit, fushat e financimit, kriteret e aplikuesit dhe afatin e aplikimit, të cilat përfshihen në dokumentet e konkurrimit dhe shpallen publikisht. Për më tepër shiko tekstin e plotë të vendimit:

<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/02/26/177/af7801c9-4e95-45e4-9d88-433ec587b8cd>

URDHËR Nr. 102, datë 21.2.2020 “PËR PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT (PSV) PËR PUNONJËSET/PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, PËR ZVOGËLIMIN E RREZIKUT TË PËRJETIMIT TË DHUNËS NË FAMILJE E TË DHUNËS ME BAZË GJINORE, NË SITUATA TË EMERGJENCAVE CIVILE”

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në situata të emergjencave civile, përshkruajnë tërësinë e veprimeve dhe të hapave thelbësorë që duhet të planifikohen, monitorohen, koordinohen, zbatohen dhe vlerësohen rregullisht, në mënyrë korrekte dhe logjike prej tyre, për të parandaluar, si dhe për të ofruar kujdesin dhe ndihmën e duhur për të mbijetuarat/it subjekt i dhunës në familje dhe i dhunës me bazë gjinore (DHF/DHBGJ), si dhe për të zvogëluar rrezikun e përjetimit të DHF-së/DHBGJ-së, gjatë përballimit të situatave të ndryshme të emergjencave civile në Shqipëri, nga gatishmëria deri në rimëkëmbje.

Në dokument parashikohen parimet dhe standardet e ofrimit të shërbimeve për të mbijetuarat subjekt i dhf-së/dhbgj-së, në paragrafin mbi qasjen me ndjeshmëri gjinore përcaktohet se shërbimet shëndetësore duhet të marrin parasysh nevojat e grupeve të veçanta të grave, të rejave dhe të vajzave, duke përfshirë ato që u përkasin grupeve të pafavorizuara (si: rome, egjiptiane, komuniteti LGBTI, PAK etj.). Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të respektojnë shumëllojshmërinë e përdoruesve dhe përdoruesve të shërbimeve dhe të zbatojnë një qasje jodiskriminuese. Kjo nënkupton që të gjitha gratë, të rejtat dhe vajzat e mbijetuara duhet të kenë qasje të barabartë dhe të plotë në shërbimet shëndetësore, njëllor si të gjithë burrat, të rinjtë dhe djemtë. Shërbimet shëndetësore duhet të ofrohen me të njëjtin nivel cilësie për të gjithë njerëzit që kanë nevojë për to, pavarësisht gjinisë, moshës, vendbanimit, përkatësisë fetare, përkatësisë etnike, aftësive të kufizuara apo orientimit seksual ndryshe.

Në lidhje me parimin e mosdiskriminimit, dokumenti përcakton se të gjitha/gjithë të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë të njëjtat

të drejta për përfitimin e shërbimeve shëndetësore, pavarësisht moshës, vendbanimit, racës, kombësisë, besimit fetar, përkatësisë etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, statusit martesor, arsimimit dhe statusit socioekonomik të tyre. Problematika e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, për vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuar, trajtohet në disa paragrafe/ kapituj të këtij udhezimi, por do të veçonim adresimin e saj përmes masave të përgjithshme dhe ato specifike për të parandalimin dhe për reagimin ndaj DHF-së/DHBGJ-së, në situata të emergjencave civile, duke filluar nga hartimi i politikave, programimi i shërbimeve shëndetësore, si dhe informimi mbi këto shërbime përfshirë masa si rritja e aksesueshmërisë së ambienteve shëndetësore për ofrimin e shërbimeve të integruara të lidhura me DHBGJ-në, duke garantuar vec të tjerash që objektet janë të aksesueshme nga të gjithë personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara; zbatimi i strategjive që rrisin në maksimum cilësinë e shërbimeve në dispozicion për të mbijetuarat/it në objektet shëndetësore, vec te tjerash duke marrë në konsideratë masat e veçanta për të plotësuar nevojat e grupeve të ndryshme në rrezik (fëmijët, LGBTI-të, personat me aftësi të kufizuara etj.); sigurimi që ndarja e informacionit dhe raportimeve të rasteve të DHF-së/DHBGJ-së brenda sektorit të shëndetësisë ose me partnerët në komunitetin më të madh humanitar, bëhet në mënyrë të sigurt dhe sipas standardeve etike dhe duke përdorur formate dhe mjete informuese të përshtatura në gjuhë të shumta (Braille, gjuha e shenjave, mesazhe të thjeshtuara si piktura dhe fotografi etj.), për të siguruar qasje të të gjithë banoreve dhe banorëve të komunitetit.

Për më tepër shiko tekstin e plotë të vendimit: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/02/21/102/4c0f7f2e-5c70-4d84-95df-3244559f4c31>

VENDIM NR.236, DATË 19.3.2020 “PËR MARRJEN E MASAVE PËR OFRIMIN E ASISTENCËS NË BANESË NDAJ SHTRESAVE NË NEVOJË, NË KUSHTET E EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID”

Në kushtet e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Qeveria Shqiptare nxorri disa vendime, disa prej të cilave garantojnë masa mbështetëse edhe për personat me aftësi të kufizuara.

VKM nr.236, datë 19.3.2020, për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, parashikon ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë nga strukturat shtetërore.

Asistenca konsiston në dërgimin e pagesave mujore që shtresat në nevojë përfitojnë nga programi i mbrojtjes sociale, nga sigurimet shoqërore dhe në dërgimin e produkteve, ushqimore e joushqimore, minimale, barnave të rimbursueshme dhe atyre me kërkesë, për përballimin e situatës apo në kryerjen e furnizimeve me produktet e mësipërme, për llogari të tyre. Sipas këtij vendimi,

shtresa në nevojë konsiderohen: a) Personat/familjet, të cilët nuk kanë familjarë të aftë për punë në njësinë administrative ku jetojnë, dhe që bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon: i. Familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike; ii. Personat me aftësi të kufizuara; iii. Personat, të cilët përfitojnë pension pleqërie. b) Personat, të cilët, pavarësisht përbërjes familjare dhe vendndodhjes së saj, bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon: i. Familjet/individët në nevojë, të cilët janë të pastrehë; ii. Familjet që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit.

Për më tepër informacion shikoni vendimin, nr.236, datë 19.3.2020 për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, në linkun <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/19/236/887aa15d-b34b-4867-a0da-78f00480beac>

Ky grant është mundësuar nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).
Përmbajtja e paraqitur nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy

